



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Procesin e Zhdëmtimit

**Ushtuesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**

Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim mbi procesin e zhdëmtimit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 tetor 2022, gjatë seancës përgatitore për gjykimin, Trupi Gjykues njoftoi palët dhe Mbrojtjen e Viktimave se në lidhje me kryerjen e procesit të zhdëmtimit synon të ndjekë të njëjtën procedurë si në çështjen KSC-BC- 2020-05 (Çështja 05), konkretisht, që procesi i zhdëmtimit të kryhet krahas procesit penal, dhe në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, të lëshojë urdhër për zhdëmtim në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).¹

2. Më 19 tetor 2022, Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen e Viktimave dhe Mbrojtjen e Pjetër Shalës (përkatësisht, Mbrojtja dhe i akuzuari) që të dorëzojnë, nëse dëshirojnë, parashtrime me shkrim për këtë aspekt deri më 11 nëntor 2022, konkretisht: (i) nëse procesi i zhdëmtimit të kryhet krahas procesit penal; dhe (ii) nëse, në rast se të shpalljes fajtor, Trupi Gjykues duhet t'i referojë viktimat për padi civile në Kosovë, në bazë të nenit 22 (9) të Ligjit dhe rregullës 167 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja), apo të lëshojë urdhër për zhdëmtim sipas neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.²

3. Më 8 nëntor 2022, Mbrojtja e Viktimave dorëzoi parashtrime (Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave).³

4. Më 11 nëntor 2022, Mbrojtja dorëzoi parashtrime (Parashtrimet e Mbrojtjes).⁴

¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 18 tetor 2022, publik, f. 383, rreshtat 10-23.

² KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 19 tetor 2022, publik, f. 408, rreshtat 8-18.

³ KSC-BC-2020-04, F00340, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, 8 nëntor 2022, publik.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00347, Mbrojtja, *Parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Procesin e zhdëmtimit*, 11 nëntor 2022, publik.

II. PARASHTRIME

5. Mbrojtja e Viktimave argumenton se: (i) duke pasur parasysh numrin e vogël të viktimave pjesëmarrëse në proces (tetë), procesi i zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore mund të kryhet paralelisht me procesin penal në një mënyrë që nuk do të cenonte të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë;⁵ dhe (ii) duke pasur parasysh aktekspertizat e dorëzuara në Çështjen 05, dhe vendimin përkatës të Trupit Gjyqësor,⁶ Trupi Gjyqësor nuk duhet t'i referojë viktimat pjesëmarrëse në proces (VPP-të) për padi civile në Kosovë.⁷ Mbrojtja e Viktimave kërkon gjithashtu që Trupi Gjyqësor, në bazë të nenit 22(7) të Ligjit, të përfshijë në aktgjykim një vendim mbi shkallën dhe përmasat e dëmit, humbjeve dhe lëndimeve të VPP-ve ose në lidhje me VPP-të, pavarësisht lëshimit të ndonjë urdhri të mundshëm për zhdëmtim.⁸

6. Mbrojtja nuk pajtohet me Mbrojtësin i Viktimave lidhur me pikën (i) më lart, dhe parashtron se procesi i zhdëmtimit duhet të kryhet pas përfundimit të procesit penal, sepse kryerja e procesit të zhdëmtimit paralelisht me procesin penal do të pengojë përfundimin e shpejtë të gjykimit penal, do të shkaktojë vonesa procedurale, dhe do të cenojë të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë.⁹ Në lidhje me këtë, Mbrojtja argumenton së pari se Trupi Gjyqësor duhet të dëgjojë dëshmi për dëmet e pësuar nga çdo VPP dhe dëshmi të ekspertëve, dhe pranimi i këtyre provave (shtesë) dhe parashtrimet në lidhje me zhdëmtimet gjatë gjykimit penal, do të "zgjasin procesin në mënyrë të pashmangshme dhe të konsiderueshme",¹⁰ dhe se Mbrojtja do të detyrohej të devijonte burime të vyera për t'u përgjigjur ndaj padive civile njëkohësisht me gjykimin.¹¹ Mbrojtja argumenton gjithashtu se kryerja e procesit të zhdëmtimit pas

⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 2, 11-14.

⁶ Shih KSC-BC-2020-05, F00310/RED, Trupi Gjyqësor I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe Kërkohej Informacion*, 4 shkurt 2022, publik.

⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 3, 17-20.

⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 4, 15-16.

⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5(i), 6-15, 18(i).

¹⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8.

¹¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 9, 13.

përfundimit të gjykimit është edhe në interes të administrimit efikas të procesit gjyqësor, sepse në rast të shpalljes së të pafajësisë, të gjitha burimet kushtuar procesit të zhdëmtimit do të shkonin dëm.¹²

7. Së dyti, Mbrojtja argumenton se arsyeja kryesore për shqyrtimin e kërkesave për zhdëmtime paralelisht me procesin penal në juridiksionet vendore – d.m.th. mundësimi i qasjes së viktimave në drejtësi – nuk zbatohet në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore.¹³ Mbrojtja parashtron se në çështjen aktuale e drejta e viktimave për drejtësi tanimë është garantuar sa duhet, sepse VPP-të: (i) përfaqësohen nga një mbrojtës kompetent që mund të paraqesë prova relevante për dëmin e mundshëm të pësuar; dhe se ato (ii) nuk duhet të referohen për padi civile në Kosovë.¹⁴ Mbrojtja pajtohet me Mbrojtjen e Viktimave se, në rast të shpalljes së fajësisë, Trupi Gjykses duhet ta dëgjojë vetë kërkesën për zhdëmtim dhe, nëse është e përshtatshme, të lëshojë urdhër për zhdëmtim në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.¹⁵ Në lidhje me këtë, Mbrojtja argumenton se “DHSK-ja duhet të jetë forumi që do të vendosë mbi kërkesat për zhdëmtime në rast të shpalljes së fajësisë, sepse është autoriteti më i përshtatshëm për të vlerësuar llojin e dëmit të pësuar prej secilës viktimë pjesëmarrëse, si edhe duke pasur parasysh kohëzgjatjen e mundshme të procesit civil dhe pasigurinë lidhur me fondet për ndihmë juridike në Kosovë”.¹⁶

8. Së treti, Mbrojtja argumenton se kryerja njëkohësisht e procesit të zhdëmtimit dhe atij penal do të ndikonte në të drejtën e të akuzuarit për të heshtur dhe krijon problemin e mosnxjerrjes së identitetit të VPP-ve për Mbrojtjen.¹⁷

¹² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13, 14.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10.

¹⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5(ii), 10, 16-17, 18(ii); Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 3, 17-20, 21(b).

¹⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16.

¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12.

9. Së fundi, Mbrojtja argumenton se kryerja e procesit të zhdëmtimit pas procesit penal do të ishte në përputhje me praktikën e shumicës së juridiksioneve penale ndërkombëtare.¹⁸

III. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

10. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 22(3), (8) dhe (9), dhe 44(6) të Ligjit, dhe rregullën 167 të Rregullores.

IV. DISKUTIM

11. Fillimisht, Trupi Gjykues vë në dukje se, në lidhje me gjykimet në Dhomat e Specializuara (DHS), Trupi Gjykues do të bëjë dallim – siç bëri në çështjen 05 – midis procesit penal *stricto sensu* që ka të bëjë me dhënien e vendimit në lidhje me akuzat e paraqitura kundër të akuzuarit, dhe procesit të zhdëmtimit, që eventualisht mund të çojë në lëshimin e një urdhri për zhdëmtim, sikurse përcaktohet në nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.¹⁹

A. KOHA E KRYERJES SË PROCESIT TË ZHDËMTIMIT SIPAS KORNIZËS LIGJORE TË DHS-SË

12. Sa i përket pyetjes së parë – nëse procesi i zhdëmtimit duhet të kryhet paralelisht me procesin penal – Trupi Gjykues rikujton interpretimin e vet të kornizës ligjore relevante të DHS-së në kontekstin e Çështjes 05.²⁰

¹⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15.

¹⁹ KSC-BC-2020-05, F00124, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 20 maj 2021, para. 9.

²⁰ *Shih* KSC-BC-2020-05, F00124, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 20 maj 2021, para. 10- 15; KSC-BC-2020-05, F00310/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe Kërkohet Informacion*, 4 shkurt 2022, publik, para. 26-31.

13. Trupi Gjykues mban në vëmendje parashtrimet e Mbrojtjes se kryerja e procesit të zhdëmtimit paralelisht me atë penal nuk duhet të shkaktojë vonesa të papërligjura ose të cenojë në ndonjë mënyrë të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë.²¹ Megjithatë, sikurse thekson me të drejtë Mbrojtja e Viktimave, aktualisht janë gjithsej tetë VPP, shtatë prej të cilëve janë viktimat jo të drejtpërdrejta.²² Provat në lidhje me shkallën dhe përmasën e dëmit të pësuar nga viktimat do të paraqiten gjatë gjykimit nga viktimat me status të dyfishtë, viktimë-dëshmitar.²³ Duke pasur parasysh faktin se viktimë e drejtpërdrejtë është vetëm një, Trupi Gjykues gjykon se çfarëdo prove e mundshme (shitesë) nga ekspertët për vlerësimin e dëmit të pësuar do të jetë e kufizuar. Provat nga ekspertët mund të ndihmojnë shqyrtimet e Trupit Gjykues dhe të palëve lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit, ose peshën e krimeve të pretenduara. Gjithashtu, korniza ligjore e DHS-së i ofron Trupit Gjykues mjetet procedurale të nevojshme për garantimin e kryerjes me drejtësi dhe shpejtësi të procesit, përfshirë mundësinë për mbajtjen e konferencave për ecurinë të çështjes për të diskutuar dhe organizuar paraqitjen e provave në lidhje me zhdëmtimin, nëse lind nevoja.²⁴ Së fundi, Trupi Gjykues thekson se kryerja e procesit të zhdëmtimit paralelisht me gjykimin në Çështjen 05 – ku numri i viktimave dhe dëshmitarëve të paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ishte i ngjashëm – nuk shkaktoi vonesë të papërligjur. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes se kryerja njëkohësisht e proceseve do të shkaktojë vonesa procedurale të konsiderueshme.²⁵

²¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8, 13-15.

²² KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 15 dhjetor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00123/RED); F00249 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 11 gusht 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën, F00249/RED); F00279, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 19 shtator 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën, F00279/RED).

²³ Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 13; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10.

²⁴ *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, publik, para. 33.

²⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8-9.

14. Sa i përket parashtrimeve të Mbrojtjes se burime të vyeshe do të shkonin dëm në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, Trupi Gjykses konstaton se koha dhe burimet që do t'i kushtohen dëgjimit të provave në lidhje me zhdëmtimet gjatë gjykimit nuk do të shkojnë dëm në rast të shpalljes së pafajësisë, sepse sipas formulimit të nenit 22(7) të Ligjit, Trupi Gjykses mund të përfshijë në Aktgjykim – në bazë të një kërkesë ose, në rrethana të jashtëzakonshme, me nismën e vet – një vendim mbi shkallën dhe përmasat e dëmit, humbjeve dhe lëndimeve të viktimave, ose në lidhje me to. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh edhe se në rast të një verdikti fajësie, zhvillimi i procesit të zhdëmtimit në vijim të tij do të kërkonte kohë dhe burime të konsiderueshme.

15. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes se kryerja e këtyre proceseve njëkohësisht do të shkaktojë vonesa procedurale të konsiderueshme ose se kryerja e procesit të zhdëmtimit pas përfundimit të gjykimit do të përmbushte më mirë parimin e administrimit efikas të procesit gjyqësor.²⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për të drejtën e të akuzuarit për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, por rikujton edhe se viktimat kanë të drejtën e zhdëmtimit *pa vonesë* për dëmin e pësuar,²⁷ në rast të shpalljes fajtor. Është detyrë e Trupit Gjykses që të sigurojë balancën e duhur midis të drejtave të të akuzuarit dhe të drejtave të VPP-ve.

16. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se e drejta e të akuzuarit për të heshtur do të komprometohej kur t'i kërkohet t'u përgjigjet padive të mundshme civile,²⁸ Trupi Gjykses vlerëson se Mbrojtja nuk arrin të faktojë se si kjo e drejtë do të ndikohej prej përgjigjes ndaj provave të ekspertëve, nëse dëshiron t'u përgjigjet atyre, lidhur me përmasat e dëmit të pësuar nga viktimat, lidhjen shkak-pasojë

²⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 8-9, 14.

²⁷ UN General Assembly, [Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#), U.N. Doc. A/RES/60/147, 16 December 2005, para. 11(e).

²⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12.

midis atij dëmi dhe krimeve që pretendohet se u kryen, dhe modalitetet e zhdëmtimit. Mbrojtja gjithashtu nuk shpjegon relevancën e proceseve vendore në Gjermani për këtë aspekt, apo të japë kontekst për to.²⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues hedh poshtë këtë argument të Mbrojtjes.

17. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se i akuzuari ka të drejtë të dijë identitetin e parashtruesve të kërkesave për zhdëmtim në mënyrë që t'u përgjigjet si duhet atyre, Trupi Gjykues vë në dukje së pari se në përputhje me nenin 23 të Ligjit dhe rregullën 80 të Rregullores, mosnxjerrja e identitetit të disa VPP-ve është para se gjithash masë mbrojtëse. Interesi që mbrohet është siguria dhe mirëqenia e viktimave, duke pasur parasysh faktorët konkretë të rrezikut të identifikuar për çdo VPP. Për këtë arsye, mosnxjerrja për Mbrojtjen e identitetit të VPP-ve nuk e pengon atë t'u përgjigjet kërkesave për dëmin e pësuar nga viktimat në kuadër të krimeve të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.³⁰ Gjithashtu, Mbrojtja nuk shpjegon se si lidhet *konkretisht* mosnxjerrja për Mbrojtjen e identiteteve të VPP-ve me kryerjen e procesit të zhdëmtimit njëkohësisht apo më pas. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vëren se juridiksione penale ndërkombëtare të tjera nuk i kanë bërë të ditura identitetet e viktimave pjesëmarrëse, edhe kur proceset e zhdëmtimit u kryen pas përfundimit të procesit penal.³¹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes.

18. Së fundi, sa i përket argumentit të Mbrojtjes se në juridiksione penale ndërkombëtare të tjera është praktikë e njohur që procesi penal dhe procesi i

²⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12, me poshtëshënimin shoqërues 11.

³⁰ KSC-BC-2020-04, F00107/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [ANNEX 1 to Submission of public redacted version of corrected Indictment](#) (Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Korrigjuar) 16 nëntor 2021, publik.

³¹ *Shih, për shembull*, ICC, *Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, ICC-01/04-01/06-3129 03-03-2015 1/97 NM A A2 A3, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals against the "Decision establishing the principles and procedures to be applied to reparations" of 7 August 2012](#), 3 March 2015, publik, with Annex A (amended order for reparations) and public Annexes 1 – 2, para. 163-168; ICC, *Prosecutor v. Ahmad Al Faqi Al Mahdi*, ICC-01/12-01/15-259-Red2, Appeals Chamber, [Public redacted Judgment on the appeal of the victims against the "Reparations Order"](#), 8 March 2018, publik, para. 88-95.

zhdëmtimit të kryhen ndaras,³² Trupi Gjykses në dukje së pari se kjo praktikë nuk është e njëtrajtshme³³ dhe, së dyti, sa u përket specifikisht proceseve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN), kjo qasje arsyetohet me kornizën e veçantë ligjore procedurale të saj, që nuk është e njëjtë me atë ku bazohen proceset para DHS-së. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses në dukje se ndonëse neni 22 i Ligjit është i ngjashëm deri në njëfarë shkalle me nenin 75 të Statutit të GJPN-së, as Ligji e as Rregullorja nuk kanë dispozitë barasvlerëse të nenit 76(3) të Statutit të GJPN-së, i cili përcakton mbajtjen e seancave shtesë, pas verdiktit të fajësisë ose dënimit, për paraqitjen e parashtrimeve sipas nenit 75 të Statutit të GJPN-së. Kjo bën që Trupi Gjykses të arrijë në përfundimin se, ndryshe nga GJPN-ja, procesi i zhdëmtimit në DHS duhet të kryhet paralelisht me procesin penal, në përputhje me kornizën ligjore të DHS-së.

19. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka arsye që të devijojë nga procedura e vendosur në Çështjen 05 dhe rrjedhimisht, në çështjen aktuale procesi i zhdëmtimit do të kryhet njëkohësisht me procesin penal.

B. REFERIMI I VIKTIMAVE PËR PADI CIVILE NË KOSOVË

20. Duke pasur parasysh vështirësitë aktuale në proceset civile në Kosovë, Mbrojtja and Mbrojtja e Viktimave pajtohen se Trupi Gjykses duhet t'i shqyrtojë vetë kërkesat për zhdëmtim, dhe jo t'i referojë viktimat për padi civile në Kosovë.³⁴

21. Fillimisht, Trupi Gjykses në dukje se neni 22(9) i Ligjit nuk përcakton kritere për të vendosur se në cilat rrethana është e përshtatshme që viktimat të

³² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15.

³³ Korniza ligjore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe ajo e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) faktikisht nuk përcaktojnë procedura në lidhje me zhdëmtimet, për dallim nga formulimi i qartë si në Ligjin ashtu edhe në Rregulloren e DHS-së. Në Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias procesi penal dhe ai për zhdëmtimin janë zhvilluar paralelisht.

³⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16-17; Parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave, para. 17-20.

referohen për padi civile në Kosovë ose, si alternativë, sikurse përcaktohet në nenin 22(8) të Ligjit, në rastin “kur Trupi Gjykses ose paneli i Gjykatës së Dhomës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin fajtor për ndonjë krim”, ai “mund të lëshojë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku specifikon zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ato viktima”. Trupi Gjykses është i mendimit se nuk është e përshtatshme t’i referojë viktimat për padi civile në gjykata të tjera në Kosovë në qoftë se ato nuk do të kenë mjete juridike efikase për ndjekjen e kërkesave të tyre për dëmshpërblim.

22. Trupi Gjykses rikujton se, sipas aktekspertizave të dorëzuara lidhur me këtë aspekt në Çështjen 05, gjykatat vendore nuk u ofrojnë viktimave të krimeve të pretenduara mundësi reale në lidhje me kërkesat për zhdëmtim dhe, edhe në qoftë se do të miratoheshin zhdëmtime me vendime të gjykatave të Kosovës, mundësi që ato vendime të zbatohen.³⁵ Njëri prej problemeve të identifikuara në aktekspertizat ishte se korniza ligjore aktuale e Kosovë nuk përmban dispozita për padi civile anonime dhe/ose mundësi për masa mbrojtëse në çështje civile në përgjithësi.³⁶ Trupi Gjykses rikujton se ky informacion është në kontrast të thellë me mundësitë në dispozicion dhe masat që zbatohen në DHS.³⁷ Trupi Gjykses mendon se, edhe pse nuk përmendet shprehimisht në nenin 22(3) të Ligjit, mbrojtja

³⁵ Shih KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe Kërkohe Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial, para. 35 dhe pas; KSC-BC-2020-05, F00287/A02, Administratorja, *Shtojca 2 e Dërgimit të Aktekspertizave, Version i Redaktuar Publik i Aktekspertizës së Parashtruar nga REDAKTUAR*, 17 dhjetor 2021, publik (Aktekspertiza e Parë); F00287/A04, Administratorja, *Shtojca 4 e Dërgimit të Aktekspertizave, Version i Redaktuar Publik i Aktekspertizës së Parashtruar nga REDAKTUAR*, 17 dhjetor 2021, publik (Aktekspertiza e Dytë); F00287/A06, Administratorja, *Shtojca 6 e Dërgimit të Aktekspertizave, Version i Redaktuar Publik i Aktekspertizës së Parashtruar nga REDAKTUAR*, 17 dhjetor 2021, publik (Aktekspertiza e Tretë).

³⁶ Shih Aktekspertiza e Parë, f. 21-24; Aktekspertiza e Dytë, para. 39-40, 42-43; Aktekspertiza e Tretë, f. 13, 21, 25, 29, 47-48.

³⁷ KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe Kërkohe Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial, para. 38.

e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë që parashihet në nenin 23 të Ligjit duhet të kuptohet si pjesë thelbësore e interesave dhe të drejtave personale të viktimave³⁸ dhe se, rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të garantojë mbrojtjen e viktimave, në përputhje me nenin 23 të Ligjit, gjatë të gjithë procesit gjyqësor, pavarësisht vendit ku zhvillohet procesi i zhdëmtimit. Për këto arsye, aftësia për të mbrojtur identitetin e viktimave, dhe për pasojë, sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të tyre dhe të familjeve të tyre, është faktor kyç që mbahet parasysh nga Trupi Gjykses gjatë vlerësimit nëse viktimat duhet të referohen për padi civile në gjykatat e Kosovës në rast të shpalljes fajtor. Aktualisht, Trupi Gjykses nuk ka informacion që sugjeron se ka pasur ndryshim të rrethanave lidhur me këtë aspekt që nga dorëzimi i aktekspertizave. Rrjedhimisht, ai nuk e gjykon të domosdoshme që të kërkojë aktekspertiza të mëtejshme lidhur me këtë aspekt dhe konstaton se referimi i viktimave në gjykata të Kosovës vazhdon të bartë rrezikun e cenimit të masave të marra nga DHS-ja për mbrojtjen e viktimave në procesin gjyqësor aktual, sepse nuk do të mundësonte mbrojtjen e mjaftueshme të identitetit të tyre.

23. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk është e përshtatshme t'i referojë viktimat të ngrenë padi civile në gjykata të Kosovës në përputhje me nenin 22(9) të Ligjit dhe rregullën 167 të Rregullores. Në vend të kësaj, në rast të shpalljes së fajësisë, Trupi Gjykses do të nxjerrë urdhër për zhdëmtim në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

24. Trupi Gjykses informon Mbrojtjen, ZPS-në dhe Mbrojtjen e Viktimave se vendimet e mëtejshme në lidhje me procesin e zhdëmtimit do të lëshohen më vonë.

³⁸ KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, publik, para. 11.

V. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues vendos që:

- (a) në çështjen gjyqësore aktuale, procesi i zhdëmtimit dhe procesi penal të kryhen njëkohësisht;
- (b) në raste të shpalljes së fajësisë, nuk do t'i referojë viktimat që të ngrenë padi civile në gjykata të Kosovës në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 9 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.